Nr. 1736 Prot

dt: 05.05.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

**FAKULTETI EKONOMIK**

Nr. 574/1 Prot Shkodër, më 05.05.2026

**Lënda: Përcjellje e urdhërit nr 4, datë 05.05.206 "Për hapjen e thirrjes për aplikim në programin e studimit Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" viti akademik 2025-2026", për publikim.**

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

**PROF.DR. TONIN GJURAJ**

Bashkëngjitur kësaj shkrese ju përcjellim urdhërin nr 4, datë 05.05.206 "Për hapjen e thirrjes për aplikim në programin e studimit Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" viti akademik 2025-2026", për publikim.

**DEKANI**

**Prof.as.dr Evdiana Bashi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

FAKULTETI EKONOMIK

DEKANI

Nr. 574 Prot Shkodër, më 05. 05.2026

**URDHËR**

**Nr. 4, datë 05.05 2026**

**"PËR HAPJEN E THIRRJES PËR APLIKIM NË PROGRAMIN E STUDIMIT "DOKTORATË" NË "EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM", VITI AKADEMIK 2025-2026"**

Sipas ligjit të arsimit të larte 80/2015, rregullores "Për organizimin e programeve të studimit të ciklit të trete të Doktoratës në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", miratuar me vendim senati nr 137 datë 28.04.2025, nenit 17, pika 3 e kesaj rregulloreje, vendimit të senatit akademik nr 128, date 23.04.2026 "Për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve për ciklin e tretë të studimeve Doktoratë "Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm", për vitin akademik 2025 - 2026, vendimit të senatit akademik nr 301 datë 20.11.2025 "Mbi miratimin e projekteve kërkimore, listës së udhëheqësve dhe kuotave të pranimit të studentëve për programin e ciklit të tretë, Doktoratë nëe "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" për vitin akademik 2025-2026 ", dhe shkresës me numër 568 prot, date: 05.05.2026, të departamentit Turizëm:

**URDHËROJ**

1. Hapjen e thirrjes për aplikime në programin e ciklit të tretë doktoratë në **"Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"**, për vitin akademik 2025 -2026, nga data 05.05.2026 – 05.06.2026.
2. Kuotat për vitin akademik 2025-2026, janë 15 Kuota.
3. Kriteret e pranimit referuar vendimit të Senatit Akademik Nr 128, datë 23.04.2026.

4. Bashkëngjitur këtij urdhri, shkresa nr 568 prot datë 05.05.2026 e njësisë bazë Turizëm, vendimi i Senatit Akademik Nr 128, datë 05.05.2026 mbi kriteret e pranimit, dhe vendimi i Senatit Akademik Nr 301, datë 20.11.2025, mbi kuotat e miratuara.
5. Dokumentacioni për aplikim do të dorëzohet gjatë ditëve të punës zyrtare, në orën 10.00 – 12.00, pranë asistentes së dekanes.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DEKANI**

**Prof.as.dr.Elidiana Bashi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - FAKULTETI EKONOMIK - UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**
**FAKULTETI EKONOMIK**
**DEPARTAMENTI TURIZËM**

Nr. 568 Prot

Shkodër, më 05.05.2026

**LËNDA: Përcjellje e dokumentacionit për hapjen e thirrjes për aplikime në programin Doktoratë "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"**

**Drejtuar: Dekanes së Fakultetit Ekonomik -Prof.as.Dr. Elidiana Bashi**

Me anën e kësaj shkrese, duke u bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr.1549 prot nr.128 datë 23.04.2026 "Për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve për ciklin e trete të studimeve në Doktoratë "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" përveç këtij vendimi që duhet të shpallet në thirrje, ju përcjellim listën e dokumenteve që duhet t'i ataçohen thirrjes për aplikim në programin e doktoratës "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" si vijon:

**Bashkëngjitur:**
1.Fushat dhe nënfushat e kërkimit shkencor;
2.Lista e projekteve kërkimore-shkencore të njësisë bazë ku përfshihet projekti i doktorantit;
3.Lista e stafit akademik të kategorisë "Profesor" në mbështetje të programit doktoratë "ETQ";
4.Modeli i paraqitjes së projekt-propozimit kërkimor të kandidatit për doktorant;
5.Lista e dokumenteve për aplikim.

**Përgjegjëse e njësisë bazë Turizëm**

**Prof. Dr. Arjeta Troshani**

UNIVERSITETI "LUIGJ GUR... SHKODËR

R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI TURIZËM

Nr. 568/1 Prot — Shkodër, më 05.05.2026

**FUSHAT DHE NËNFUSHAT E KËRKIMIT SHKENCOR TË DOKTORATURËS "EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM"**

**Fushë kryesore e kërkimit shkencor:** EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM

## Nënfushat e kërkimit shkencor:

- Menexhimi i turizmit të qëndrueshëm
- Planifikimi strategjik i avancuar i destinacioneve turistike
- Ekonomiksi i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit
- Ruajtja dhe menexhimi i biodiversitetit
- Sistemet e informacionit në turizëm
- Ekonomiksi i ambjentit në turizëm
- Turizmi detar
- Turizmi i verdhë
- Sipërmarrja sociale dhe inovacioni
- Restaurim i qendrave urbane dhe i peisazhit historik për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm
- Rikuperimi dhe rijetëzimi i monumenteve për zhvillim turizmi të qëndrueshëm
- Menaxhimi i pasurisë kulturore për zhvillim turizmi të qëndrueshëm
- Menexhimi i kanalit të shpërndarjes në mikpritje
- Diskursi në turizëm

**Përgjegjëse e njësisë bazë Turizëm**

Arjeta Troshani

**Prof.dr.Arjeta Troshani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TURIZËM

Nr.568/2 Prot Shkodër, më 05.05.2026

**LISTA E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE QË ZHVILLOHEN NGA NJËSIA BAZË, KU MBËSHTETEN PROJEKTET INDIVIDUALE TË DOKTORANTËVE:**

1. Planifikimi strategjik i avancuar i destinacioneve turistike
2. Menexhimi i projekteve
3. Menexhim turizmi të qëndrueshem
4. Ekonomiksi i Zhvillimit të Qëndrueshëm
5. Sipërmarrje Sociale dhe Inovacioni
6. Sistemet e informimit në turizëm
7. Kërkesa dhe oferta turistike, qëndrueshmëria e shërbimeve: Evidencë nga destinacionet shqiptare.
8. Ruajtja dhe menexhimi i biodiversitetit

Përgjegjëse e njësisë bazë Turizëm

Prof.dr.Arjeta Troshani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**
**FAKULTETI EKONOMIK**
**DEPARTAMENTI TURIZËM**

Nr. 568/3 Prot

Shkodër, më 05.05.2026

**Lista e stafit akademik për t'u angazhuar si udhëheqës shkencor në programin e doktoratës "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" për vitin akademik 2025—2026**

| Udhëheqës Shkencorë | Adresat e emailit |
|---|---|
| Prof. Dr Arjeta Troshani | arjeta.troshani@unishk.edu.al |
| Prof.Dr Fatbardha Molla | fatbardha.molla@unishk.edu.al |
| Prof.Dr Anila Neziri<br>Prof As Dr Ariana Laçaj (Striniqi) | anila.neziri@unishk.edu.al<br>ariana.lacej@unishk.edu.al |
| Prof Dr Blerta Dragusha | blerta.dragusha@unishk.edu.al |
| Prof Dr Ermira Kalaj | ermira.kalaj@unishk.edu.al |
| Prof As Dr Entela Hoxhaj<br>Prof As Dr Emanuela Furramani | entela.hoxhaj@unishk.edu.al<br>emanuela.furramani@unishk.edu.al= |
| Prof As Dr Irma Baraku<br>Prof As Dr Adrian Leka | irma.baraku@unihsk.eud.al<br>adrian.leka@unihsk.edu.al |
| Prof Dr Adem Bekteshi | adem.bekteshi@unishk.edu.al |
| Prof As Dr Fatbardha Osmanaga<br>Prof.as.dr.Eranda Halluni | fatbardha.osmanaga@unishk.edu.al<br>eranda.halluni@unishk.edu.al |
| Prof As Dr Nevila Mehmeti | nevila.mehmetaj@unishk.edu.al |
| Prof As Dr Medjon Hysenaj | medjon.hysenaj@unishk.edu.al |
| Prof As Dr Zamira Shabani | zamira.shabani@unishk.edu.al |
| Prof As Dr Paulina Guli | paulina.guli@unishk.edu.al |
| Prof As Dr Florian Bianku | florian.bianku@unishk.edu.al |
| Prof As Dr Alva Dani<br>Prof As Dr Bresena Kolpliku | alva.dani@unishk.edu.al<br>bresena.kopliku@unishk.edu.al |

**Përgjegjëse e njësisë bazë Turizëm**

**Prof.dr.Arjeta Troshani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TURIZËM

Nr. 568/4 Prot Shkodër, më 05.05.2026

# MODELI I PARAQITJES SË PROJEKT-PROPOZIMIT KËRKIMOR TË KANDIDATIT PËR DOKTORANT NË 'EKONOMI DHE TURIZËM TË QËNDRUESHËM'

1. **Fusha e përzgjedhur e kërkimit** (nga fushat e miratuara të kërkimit në aplikimin e programit të Doktoraturës – bashkëngjitur lista e fushave të miratuara të kërkimit)
2. **Udhëheqësi shkencor** i propozuar (nga lista që i bashkangjitet për pedagogët e kategorisë "Profesor" si mbështetës të programit të Doktoraturës me udhëheqje shkencore të studentëve doktorantë)
3. **Përshkrimi i situatës aktuale** (Përshkrimi i situatës aktuale të fushës kërkimore, konteksti dhe hapësira e zhvillimit të kërkimit dhe arsyetimit që justifikon nevojën e ndërrmarrjes së këtij propozimi kërkimor – deri 500 fjalë)
4. **Pyetja kërkimore, qëllimi dhe objektivat e kërkimit** (evidentim i qartë i pyetjes/pyetjeve kërkimore, i qëllimit të kërkimit dhe listimi i objektivave kërkimore)
5. **Rishikim i literaturës** (maksimumi 1 faqe)
6. **Metodologjia e kërkimit të projekt propozimit** (Përshkrimi i metodologjisë së kërkimit shkencor)
7. **Rezultatet e pritshme dhe risitë e projekt propozimit** (Rezultatet e lidhura me objektivat e kërkimit, risitë dhe kontributi akademik dhe praktik i pritshëm i studimit kërkimor)
8. **Biblografia dhe web-biblografia**

**Përgjegjëse e njësisë bazë Turizëm**
**Prof.dr.Arjeta Troshani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**
**FAKULTETI EKONOMIK**
**DEPARTAMENTI TURIZËM**

Nr.568/5 Prot                                                    Shkodër, më 05.05.2026

## Dokumentacioni që kërkohet për aplikim:

1. Curriculum vitae me foto personale;
2. Letër Motivimi;
3. Fotokopje të kartës së identitit/pasaportës dhe dy fotografi;
4. Vërtetim për adresën/rezidencën e banimit;
5. Kopje e noterizuar e diplomave dhe listës së notave të studimeve ose çertifikatë të njehsimit të tyre nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë;
6. Dëshmi të gjuhës së huaj (kopje e noterizuar) që vërteton plotësimin e kriterit për gjuhën e huaj;
7. Dy rekomandime prej personelit që gëzon titullin "Profesor" ose "Profesor i Asociuar" të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
8. Vërtetim nga qendra e punës dhe vërtetim page që vërteton kandidati është i punësuar personel akademik pranë një IAL, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
9. Propozimi i kandidatit për projektin e kërkimit shkencor të tij i cili duhet të jetë në përputhje me fushën e kërkimit sheknc or dhe projektet e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit të miratuara nga njësia bazë Turizëm, ku kandidati të përcaktojë nevojën për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që sjell punimi, metodologjia kërkimore që do të ndiqet, plani i punës kërkimore-shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore;
10. Deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin;
11. Vërtetim nga institucioni ku aderon si pedagog ose kërkues shkencor që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
12. Vetëdeklarim të mospasjes së ndonjë shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo të mos shkeljes së rregullave mbi plagjiaturën.
13. Vetëdeklarim i kandidatit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike të kërkimit shkencor e publikimit;
14. Deklaratë vetjake e kandidatit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës;
15. Mandat pagese për tarifën e aplikimit në ALL.

Emër Atësi Mbiemër i kandidatit (Firma)

_______________________________________

**Përgjegjëse e njësisë bazë Turizëm**

**Prof.dr.Arjeta Troshani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 4175 Prot. Shkodër, më 20. 11. 2025

# VENDIM

Nr. 301, datë 20.11 2025

## "PËR MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE, LISTËS SË UDHËHEQËSVE DHE KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË, DOKTORATË NË "EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM", PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 69, pika 3; Statutin e USH-së, neni 17, pika 6, germa n), neni 53, pika 1. Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim propozimin e njësisë kryesore, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2025,

## VENDOSI:

1. Miratimin e projekteve kërkimore, listës së udhëheqësve dhe kuotave të pranimit të studentëve për programin e studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm", për vitin akademik 2025-2026, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.
3. Ky vendim, pas miratimit përfundimtar, i përcillet Ministrisë së Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof. Dr. [illegible] GJURAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

SENATI AKADEMIK

Nr.154 prot. Shkodër, më 23.04 2026

# VENDIM

Nr. 128, datë 23 . 04 .2026

**"Për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve për ciklin e tretë të studimeve Doktoratë "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm", për vitin akademik 2025-2026"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 72, 74 dhe 76; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa *o*, Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim propozimin e Fakultetit Ekonomik, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2026

**Vendosi:**

1. Miratimin e kritereve të pranimit për ciklin e tretë të studimeve Doktoratë "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm", për vitin akademik 2025-2026 (materiali bashkëngjitur).
2. Ky vendim t'i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof. Dr. Tonin GJURAJ**

# KRITERET E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026

## CIKLI I TRETË, "DOKTORATË"

| KRITERET E PRANIMIT NE UNIVERSITETE 2025 - 2026 | | | |
|---|---|---|---|
| Cikli i tretë i Studimeve Doktoratë | | | |
| **IAL** | **Fakulteti** | **Programi i studimit** | **Kriteret** |
| **Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"** | **Fakulteti Ekonomik** | **Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"** | Të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë të paktën njërën nga diplomat "Master i Shkencave", "Master i Arteve", "Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë", "Diplomë e Nivelit të Dytë", "Diplomë Master Ekzekutiv", "Diplomë lëshuar në Republikën e Shqipërisë për programin e studimit që ka zgjatur, së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës", apo diplomë nga një program studimi të barasvlefshëm të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga Ministria përgjegjëse e Arsimit në Shqipëri;<br>-Të ketë rezultate të larta të studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë;<br>-Të ketë të mbrojtur me test ndërkombëtar një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht në përputhje me nivelet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në lidhje me nivelet e gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të tretë;<br>-Të ketë dy rekomandime prej personelit me titull akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar", të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;<br>-Të mos ketë aktualisht masa disiplinore ndaj tij në institucionet e arsimit të lartë, apo në institucionin e kërkimit bazë ose të zbatuar ku kandidati është i angazhuar; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | -Të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave mbi plagjiaturën;<br>-Të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standartet shkencore dhe etike të kërkimit shkencor.<br>**Kritere specifike:**<br>- Të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë të paktën njërën nga diplomat "Master i Shkencave", "Master i Arteve", "Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë", "Diplomë e Nivelit të Dytë", "Diplomë Master Ekzekutiv", "Diplomë lëshuar në Republikën e Shqipërisë për programin e studimit që ka zgjatur, së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës", ose diplomë ekuivalente me to, në fushën e Ekonomisë/Turizmit ose në fusha të ngjashme dhe /ose të ndërlidhura me fushën e Dokoraturës në bazë të Akt-marrëveshjeve të lidhura të Departamentit të Turizmit, FEUNISHK. |
| | | | |